



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo  
Skupština Opštine štrpce  
Kuvendi i Komunes se Shtërpcës  
Municipality of Strpce

Në bazë të nenit 12 dhe 54 të Ligjit Mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenit 38 të Statutit të komunës së Shtërpcës nr. 01/898 të datës 14.07.2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më datën: 26.02.2018, mori këtë:

#### V E N D I M

#### PËR ZGJEDHJEN E ZEVENDËS KRYESUESIT TË KOMUNITETEVE NE KUVENDIN E KOMUNËS SË SHTËRPCËS

1. Garip Sahiti , anëtar i kuvendit të komunës nga subjekti politik i PDK-së , zgjedhet Zëvendës Kryesues i Komuniteteve ne Kuvendin e Komunës se Shterpces.
2. Mandati i Zëvendës Kryesuesit për Komunitete filloj nga dita e emërimit dhe zgjatë aq sa zgjatë mandati i Kuvendit të Komunës.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zëvendës Kryesuesit për Komunitete janë te përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës si dhe Rregulloren e punës se kuvendit te komunës.
4. Paga për punën e Zëvendës Kryesuesit për Komunitete, rregullohet sipas ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative për pagesën e stafit politik.
5. Ky vendim hyn ne fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Shtërpcës.

#### A r s y e t i m

Pas perfundimit te procesit te zgjedhjeve lokale 2017 dhe certifikimit te rezultateve perfundimtare nga KQZ rezulton se dy kandidat nga radhët e subjekteve politike nga komuniteti jo shumicë kan dale me numër te barabartë te votave.

Sipas Ligjit te Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 qe ka te beje zëvendës kryesuesin për komunitete ku në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve gjegjësisht për kandidatin përfaqësues i popullatës jo shumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës.

Nga kjo qe u tha me larte duke marre pr baze qe LVL nuk ka parapare situata te tilla, komuna e Shterpces ka bere kerkese nr.02-030/01-8802/17 me daten 27.11.2017 per konsultim paraprak prane MAPL-ja dhe se ka marr pergjegje me shkrim nr.013-1057/2 te dates 12.01.2018 , sipas se ciles **“ Rezultati i zgjedhjeve ku dy kandidatet me numer te barabart te votave si kandidatet me te votuar, e qe gezojn te drejten per te qene zevendes kryesues i kuvendit te komunes per komunitete, eshte situat e cila nuk eshte parapar me ligj”** dhe se ne kete rast **“zgjedhja do te ishte nje marreveshje ne mes dy subjekteve ose permes shortit”**

Kryesuesi i Kuvendit te Komunes se Shterpces ka organizuar nje takim me daten 26.02.2018, para fillimit te seances se kuvendit ku ka biseduar me subjektet gjegjesisht kandidatet me numer te barabart te votave me qellim te arritjes se nje marreveshje, mirpo nje gje e tille nuk eshte arritur pasi te gjitha opcionet e diskutuara nuk kan qene te pranushme per te dy palet, ngase opcioni i pranuar nga njera pale nuk ka qene i pranueshem per palen tjeter.

Kryesuesi i kuvendit te komunes ne mbledhjen e kuvendit gjat diskutimit te kesaj pike te rendit te dites, i ka njoftuar anetaret e kuvendit te komuns per situaten e krijuar dhe ka hapur debat lidhur me kete qeshtje per te hapur rruge permbushjes se obligimit ligjore qe kuvendi i komunes te kete zevendes kryesuesin per komunitete.

Gjat kesaj seance ka pasur propozim qe pasi nuk ka marreveshje ne mes paleve per te zgjedhur zevendes kryesuesin ateher kjo qeshtje te vihet ne votim dhe te zgjedhet me votim nga ana e kuvendit te komunes.

Kryesuesi i Kuvendit i komunes ka vene ne votim opcionin e hedhjes se shortit dhe zgjedhjen e zevendes kryesuesit me votim ashtu siq ka patur propozim nga anetaret e kuvendit, me qrast kuvendi me 14 vota per ka vendosur qe zevendese kryesuesi te zgjidhet me votim, ndersa 1 vot ka qene qe kryesuesi te zgjidhet me short.

Gjithashtu Kuvendi ka votuar edhe per formen e votimit te zgjedhjes se zevendes kryesuesit, dhe se me shumic votash eshte vendosur qe votimi te behet me votim te fsheht.

Keshtu qe pas votimit ka rezultuar se kandidati i percaktuar ne piken 1 te ketij vendimi ka marr 13 vota 2 kan qen te pa vlefshme dhe se kunderkandidati nuk ka pasur asnje vote.

Nga kjo qe u tha me larte eshte konstatuar se eshte zgjedhur zevendes kryesuesi per komunitete ne nje proces te drejt demokratik ngase ligji nuk ka parapar nje menyrr ligjore te zgjedhjes ne rastin konkret.

Pjese perberese e ketij vendimi do te konsiderohet proceverbali i seances se Kuvendit te Komunes.

Me kete vendim njoftohen: I zgjedhuri ,Kryesuesi, Kryetari, Udhëheqësi i Personelit, Drejtoria për Buxhet Financa, MAPL, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
Predrag Grbic

